

VENDIM
Nr.853, datë 5.8.2009

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT
E NJERIUT, DATË 7.7.2009, PËR ÇËSHTJEN NR.25336/04, “GRORI KUNDËR
SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore””, e të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të datës 7.7.2009, për çështjen nr.25336/04, “Groni kundër Shqipërisë”, në shumën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.

2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave dhe afati, brenda të cilit duhet kryer ky ekzekutim, është data 7.9.2009.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Shuma e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në njërin nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z. Arben Groni, dhe të konvertohet në lekë, sipas kursit të këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e çeljes së llogarisë.

5. Pagesa e kësaj shume në favor të ankuesit, z. Arben Groni, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes të të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha